



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES  
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2022

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

**Për:** Operatorin ekonomik “SALILLARI” sh.p.k., me NUIS J62903125G dhe adresë: “Lagjja Vorë, rruga e vjetër, Vorë-Marikaj, Km 1, godina 4 katëshe, kati 3, nr. 5, Vorë”

**Tiranë**

Procedura e prokurimit: “Procedurë e kufizuar - prokurim në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”.

Numri i referencës së procedurës (nr. datë urdhër prokurimi): Urdhri i Prokurimit nr. 28, datë 29.03.2022.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Ndërtimi i perimetrit të sigurisë në Bazën Ajrore Kuçovë (ndriçimi, vendosja e kamerave të sigurisë dhe vendosja e sensorëve të zbulimit të ndërhyrjeve përgjatë rrethimit)”, me fond limit 458,143,000 (katërqind e pesëdhjetë e tetë milionë e njëqind e dyzet e tre mijë) lekë pa TVSH.

Publikime të mëparshme: Nuk ka patur.

Kohëzgjatja e kontratës: Duke filluar nga data e fillimit të punimeve me përfundim brenda 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditëve.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- Operatori ekonomik “SALILLARI” sh.p.k., me NUIS J62903125G dhe ofertë në vlerën 434,713,137 (katërqind e tridhjetë e katër milionë e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.
- Operatori ekonomik “HASTOÇI” sh.p.k., me NUIS J62028009B dhe ofertë në vlerën 425,983,931 (katërqind e njëzet e pesë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- Operatori ekonomik “HASTOÇI” sh.p.k., me NUIS J62028009B.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “HASTOÇI” sh.p.k., me NUIS J62028009B, sh.p.k., ka gabime aritmetike dhe shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë në një vlerë më të lartë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar. Konkretisht në ofertën e paraqitur

nga ky ofertues, vlera e punimeve të seksionit “IV. Instalimet e sistemit me sensor fiber optike me tvsh” duhet të ishte në shumën 37,499,972 lekë dhe jo 34,099,972 lekë.

Gjithashu edhe vlera e punimeve të seksionit “d. Vlera e pajisjeve elektrike per instalimet me sensor fiber optike me tvsh” duhet të ishte 29,473,200 lekë dhe jo në shumën 3,553,200 lekë.

2% e vlerës së ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “HASTOÇI” sh.p.k., është = 2% \* 425,983,931 = 9,023,078.63 lekë.

Shuma absolute e korigjimeve është 25,170,000 lekë, vlerë kjo më e lartë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

Për sa më sipër, oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “HASTOÇI” sh.p.k., me NUIS J62028009B, refuzohet bazuar në pikës 4, të nenit 50, të rregullave në FMS, ku parashikohet se: “...Ofertat me gabime aritmetike **refuzohen**, kur shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më të larta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar”.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “SALILLARI” sh.p.k., me NUIS J62903125G dhe adresë: “Lagjja Vorë, rruga e vjetër, Vorë-Marikaj, Km 1, godina 4 katëshe, kati 3, nr. 5, Vorë, Tiranë”, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 434,713,137 (katërqind e tridhjetë e katër milionë e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në LPFMS dhe nenit 62 të VKM 1170/2020.

## TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR